



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:088667

Datë: 07.05.2024

Numri i dokumentit: 05711289

Ac.nr.10475/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Dardan Kadolli, kryetar i kolegjit, Nehat Idrizi dhe Hunaida Pasuli, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit E. G. nga F.K., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Gj. D., avokat në Prishtinë, kundër të paditurës “M.-G.” Sh.p.k, me seli në Fushë Kosovë, me objekt kontesti anulim i vendimi dhe kompensimin e pagave, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës, e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.2136/16, të datës 29.07.2021, në seancën e kolegjit, të mbajtur me datë 07.05.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. REFUZOHET** pjesërisht e pabazuar ankesa e të paditurës “M. G.”, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.2136/16, të datës 29.07.2021, në pikën I (një), II (dy), IV (katër) të dispozitivit VËRTETOHET.
- II. APROVOHET** pjesërisht e bazuar ankesa e të paditurës “M.-G.” Sh.p.k, me seli në Fushë Kosovë, NDRYSHOHET aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.2136/16, të datës 29.07.2021 në pikën III (tre) të dispozitivit, në pjesën e aprovuar të kërkesëpadisë së paditësit E. G. nga F. K. përkitazi me kompensimin e të ardhurave personale, si dhe rrjedhën e kamatës, ashtu që për këtë pjesë gjykohet si në vijim: DETYROHET e paditura “M.-G.” Sh.p.k, me seli në F. K., që paditësit E.G. nga F. K., në emër të kompensimit të ardhurave personale për periudhën nga data 01.09.2016 deri me datë 31.12.2016, të i’u paguaj shumën prej 920€ bruto, me kamatë ligjore prej 8% e llogaritur nga

data 31.12.2016 deri në pagesën definitive, kurse pjesa e tjetër e kërkesëpadisë që ka të bëjë me kompensimin e të ardhurave personale refuzohet e pa bazuar.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar, C.nr.2136/160, të datës 29.07.2021, ka vendosur si vijon: I. APROVOHET e bazuar kërkesëpadija e paditësit E. G. nga F. K. II. ANULOHET njoftimi për shkëputjen e kontratës së punës dhe vendimi për ndërprerjen e marrëdhënies së punës të paditurës “M. G.” sh.p.k me seli në F. K. të datës 26.08.2016 si jo të ligjshëm. III. DETYROHET e paditura “M.-G.” Sh.p.k me seli në F. K., që në emër të kompensimit të ardhurave personale për periudhën nga data 27.08.2016 e deri më datë 31.12.2016 t’ia paguaj paditësit në emër të pagave neto shumë prej 3,607.35 euro me kamatë 8 % duke llogaritur nga data 27.08.2016 e deri në pagesën definitive, në emër të kontributit pensional shumë prej 209.66 euro dhe në emër të tatimit në pagë shumë prej 376.15 euro, në afat prej 7 ditësh pas pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm. IV. DETYROHET e paditura që paditësit t’ia paguajë shpenzimet procedurale në shumë prej 1,089.00€, në afat prej 7 ditësh pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm.

Kundër këtij aktgjykimi e paditura përmes përfaqësuesit të saj, brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë, duke e atakuar aktgjykimin e goditur për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit ta prish aktgjykimin e atakuar dhe çështjen ti ia kthej gjykatës se shkalles se pare ne rishqyrtim dhe rivendosje, apo aktgjykimi i goditur të ndryshohet dhe kërkesëpadija e paditësit të refuzohet si e pabazuar si dhe e paditura të lirohet nga detyrimi që paditësit ti bëjë kompensimin e pagave për periudhën kohore nga data 27.08.2016 dhe deri me datën 31.12.2016, me kamatë ligjore, si dhe pagesën e shpenzimeve të procedurës.

Nga shkresat e lëndës nuk mund të gjendet se paditësi të ketë parashtruar përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

- Ankesa e të paditurës është pjesërisht e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi E.G. nga F. K., përmes të autorizuarit të tij, me datë 22.09.2016, në gjykatën e shkallës së parë, ka paraqitur padi, për shkak se paditësit me njoftim të datës 26.08.2016 i ndërpritet kontrata për marrëdhënien e pune në kohë të caktuar, afati i të cilës do të duhej të përfundonte me datë 21.12.2016, me arsye sipas të paditurës ka pretenduar të ngacmoj një punëtoare te subjektit VFS (viva fresh store). I padituri i pakënaqur me njoftimin e datës 22.09.2016 si dhe me akuzat ndaj tij ka paraqitur padi pranë gjykatës

Themelore në Prishtinë, me të cilin ka kërkuar që të aprovohet padia, të anulohet në tersi si i paligjshëm njoftimi i datës 26.08.2016 i të paditurës dhe detyrohet e paditura të bëjë kompensimin e të ardhurave personale, së bashku me shpenzimet e procedurës kontestimore.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësit, pas vlerësimit të provave që janë ofruar nga përfaqësuesit e ndërgjyqësve, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar, duke aprovuar kërkesëpadinë e paditësit.

Në arsyetimin e aktgjykimit të ankimuar, gjykata e shkallës së parë fillimisht ka administruar provat: Kontrata e punës për periudhë të caktuar kohore nr. 279 e datës 20.05.2011; Aneksi nr. 8 mbi vazhdimin e kontratës së punës nr. 261/2016 e datës 22.06.2016; Vendimi për shkëputjen e kontratës dhe ndërprerjen e marrëdhënies së punës nga punëdhënësi e datës 26.08.2016; Njoftimi për shkëputjen e kontratës së punës nga punëdhënësi; Kundërshtimi i paditësit datë 02.09.2016; Komunikimet me email të datës 24.08.2016, 18.12.2013 dhe 19.12.2013; Ekspertiza financiare e datës 15.09.2019; Rregullore për marrëdhënie pune dhe përgjegjësi për kryerjen e detyrave të punës e vitit 2013; Përgjigja në kërkesë nga ATK-ja e datës 14.06.2021; Pasqyrë e të ardhurave personale e datës 06.11.2021 si dhe Lista e pagave për të punësuar. Gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar se është vërtetuar se paditësi me të paditurën kishte kontratë të punës me afat të caktuar, të vlefshme deri me 31.12.2016. Përmes administrimit të vendimit për shkëputjen e kontratës së punës të datës 26.08.2016 gjykata ka gjetur se arsye për ndërprerjen e kontratës së punës ishte përsëritja e keq sjelljes së paditësit.

Më tej gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar se e paditura me rastin e shkëputjes së marrëdhënies së punës paditësit nuk i ka zbatuar kushtet ligjore që dalin nga dispozitat ligjore të Ligjit të Punës dhe si rezultat i kësaj vendimi për shkëputjen e kontratës së punës paditësit është i paligjshëm, pasi që i njëjtit është marr në kundërshtim të plotë me dispozitat e Ligjit të Punës. Përpos shkeljeve të gjetura, Gjykata vlerëson se e paditura konform Nenit 71 par 2. të Ligjit të Punës ka dështuar ta njoftojë me kohë paditësin për ndërprerjen e kontratës së punës, pasi që vendimin për ndërprerje të kontratës ia kishte dorëzuar të njëjtën ditë kur e kishte njoftuar për ndërprerjen e marrëdhënies së punës, për çfarë është vërtetuar nga provat e administruara në këtë proces gjyqësor dhe po ashtu është pohuar nga i autorizuari i të paditurës në shqyrtimin gjyqësor të datës 25.05.2021. Për kompensimin e të ardhurave, ka arsyetuar se është bazuar në vlerësimin e ekspertit financiar, i cili llogaritjet i ka bërë mbi bazë të realizimit të pagave për muajt paraprak, para se të shkëputej marrëdhënia e punësimit.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, por e drejta materiale është aplikuar gabimisht në pjesën që aktgjykimi është ndryshuar.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit nuk qëndron pretendimi ankimor i të paditurës se aktgjykimi i ankimuar është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika n) e LPK-së sepse dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë edhe me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë ku në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar qartë mënyrën se si janë vërtetuar faktet dhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar, të cilat janë të pranueshme edhe për këtë gjykatë.

Gjykata e Apelit, e ka pranuar në tërësi vlerësimin e gjykatës së shkallës së parë referuar gjendjen faktike të vërtetuar më pas duke e kualifikuar në përputhje me normat materiale, pasi që nga shkresat e lëndës rezulton se nuk ka qenë rrethanë kontestuese fakti së paditësi ka qenë në marrëdhënie pune tek e paditura dhe se të njëjtit i është ndërprerë marrëdhënia e punës, me njoftimin e të paditurës të datës 26.08.2016. Sipas të njëjtit njoftim marrëdhënia e punës i shkëputet për shkaqe morale, me pretendimin e ngacmimit të një punëtore të subjektit UFSI.

Nga shkresat e lëndës rezulton se marrëdhënia e punës në mes paditësit dhe të paditurës ka qenë e rregulluar me kontratën e punës të datës 30.05.2011, me të cilën paditësi kishte themeluar marrëdhënie pune në kohë të caktuar si koordinator, me lartësi të pagës 230€ bruto në muaj. Kjo kontratë pune, ishte përtërirë me anekse të kontratave, ashtu që sipas aneksit nr. 8 datë 22.06.2016, e njëjta do të skadonte me datë 31.12.2016. Më tej për sa i përket pretendimit ankimor që ka atë bëjë me vërtetimin e gabuar po jo të plotë të gjendjes faktike, kolegji arrit në përfundim se e paditura nuk ishte arritur të provonte në masën e duhur të provonte shkeljet që i kishte ngarkuar paditësit. Pas njoftimit për shkëputjen e kontratës së punës, e paditura ka ofruar një vendim për shkëputjen e kontratës së punë, datë 26.08.2016, në të cilin ka cekur se paditësi i ndërpritet marrëdhënia e punës për shkak të ngacmimit që i kishte bërë një punëtoreje, po ashtu përformaca e paditësi mbetet e pakënaqshme përkundër vërejtjeve të shumat të dhëna me shkrim dhe me gojë. Bazuar në provat që kishte administruar gjykata e shkallës së parë, nuk është vërtetuar se realisht kur dhe si është bërë ai ngacmim që i ngarkohej paditësit, nuk vërtetuar saktësisht i njëjti pretendim. Gjykata e shkallës së parë ka marrë vendim bazuar në provat e administruara të cilat janë propozuar nga ndërgjyqësit. Nga analizimi i thënieve në ankesë, nuk është gjendur se cilat ishin ato prova që gjykata e shkallës së parë i ka vlerësuar në mënyrë të gabuar, në atë mënyrë që ka keq interpretuar përmbajtjen e tyre, apo se nuk është vërtetuar plotësisht gjendja faktike, duke bërë të njohur për këtë gjykatë se një provë e caktuar do të dërgonte tek një gjendje tjetër faktike.

Bazuar në gjendjen faktike të vërtetuar drejtë, gjykata e shkallës së parë ka arritur që të bëjë vlerësimin e saj në harmoni me Ligjin e Punës Nr.03/L-212, i cili përcakton kriteret themelore që i përkasin procedurës disiplinore që punëdhënësit duhet të ndjekin, për të punësuar që aplikohet ky ligj.

Gjykata e Apelit vlerësoi pretendimin ankimor për sa i përket aplikimit të së drejtës materiale, sido që të jetë për këtë gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare, duke gjetur si pretendim të pa bazuar, ngase gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë ka zbatuar të njëjtën.

Gjykata Apelit vlerëson se me të drejtë gjykata e shkallës së parë ka konstatuar se vendimi i të paditurës për ndërprerjen e marrëdhënies së punës kundrejt paditësit është i kundërligjshëm sepse e paditura nuk e ka njoftuar paraprakisht paditësin për ndërprerjen e marrëdhënies së punës, njëkohësisht nuk ka vërtetuar gjendjen e fakteve për sa i përket ngacmimit që pretendohet se ai ka bërë. Në udhëheqje të një procedure disiplinore për një shkelje që pretendohet të ketë kryer një i punësuar, është e rëndësishme provimi i asaj shkelje më pas vendimi për largim të cilësohet si i ligjshëm. Në anën tjetër, në vendimin kontestues për shkëputje të kontratës së punës përmendet performanca e dobët, përkundër vërejtjeve të bëra. Lidhur me këtë në nenin 70 par. 1 pika 1.1, 1.2 të Ligjit të Punës parashihet: Punëdhënësi mund t'ia ndërpresë kontratën e punës të punësuarit me një periudhë paralajmërimi, atëherë kur: 1.1. ndërprerja e tillë arsyetohet për arsye ekonomike, teknike ose organizative i punësuarit nuk është më i aftë t'i kryejë detyrat e punës. Kurse par. 3 të të njëjtit nen: Punëdhënësi mund ta ndërpresë kontratën e punës në bazë të nën-paragrafit 1.6. të paragrafit 1. Të këtij neni vetëm atëherë kur i punësuarit ka marrë përshkrimin në formë të shkruar të performancës së pakënaqshme, një afat të përcaktuar kohor brenda të cilit i punësuarit duhet ta përmirësojë performancën e vet, si dhe një deklaratë se dështimi për përmirësimin e performancës do të rezultojë me largim nga puna pa asnjë paralajmërim të mëtejshëm me shkrim. Më tej par. 3: Punëdhënësi duhet që të mbajë takim me të punësuarin për t'ia shpjeguar atij/asaj ndërprerjen e kontratës së punës ose me qëllim që t'ia dorëzojë paralajmërimin, i punësuarit ka të drejtë që të shoqërohet nga një përfaqësues sipas dëshirës së vet. Në rastin kontestues në gjykimin në shkallës së parë, pala ankuese nuk ka provuar që më parë të jetë parashtruar ndonjë vërejtje lidhur me ushtrimin e pakënaqshëm të detyrave të punës apo marrjen e ndonjë mase lidhur me përsëritjen e vazhdueshme të mungesës së performancës në punë. Pjesa arsyetuese e vendimit të të të paditurës se ndaj paditësit ka pasur vërejtje të shumta, nuk është provuar, rrjedhimisht vendimi për largim drejtë është vlerësuar nga gjykata e shkallës së parë si jo i ligjshëm.

Gjykata e Apelit në vlerësim të pretendimeve ankimore, ka gjetur se ankesa e të paditurës është e pjesërisht e bazuar në pjesën e pikës II (dy) të dispozitivit të aktgjykimit të shkallës së parë, që ka të bëjë me kompensimin e pagave, si dhe rrjedhën e kamatës ligjore, ngase në këtë pjesë kemi zbatim të gabuar të së drejtës materiale. Po ashtu, nga kolegji, me anë të vlerësimit ndryshe të shkresave dhe provave të marra në mënyrë indirekte, ka konstatuar gjendje që ndryshon nga vlerësimi që ka bërë gjykata e shkallës së parë.

Nga kontrata e lidhur ndemjet ndërgjyqësve, si dhe anekset e kontratave, të cilat janë administruar nga gjykata e shkallës së parë, është vërtetuar se paditësit i është shkëputur kontrata e punës katër muaj para se t'i skadonte, gjegjësisht me datë 26.08.2016. Po ashtu të njëjtit nuk i është bërë kompensimi i pagave për katër paga nga shtatori deri në dhjetor, kurse paga bazë mujore e tij ishte 230€ në muaj. Rrjedhimisht si detyrim ndaj paditësit janë pagat

për muajt e mbetur prej katër pagave bazë. Gjykata e shkallës së parë është bazuar në vlerësimin sipas ekspertizës, përmes së cilës kalkulimi ishte bërë bazuar në realizimin e pagave që paditësi kishte bërë muajt paraprak, para se të ndërpritej marrëdhënia e punës, në këtë mënyrë duke llogaritur edhe shtesën sipas qarkullimit të mallit që ai mbulonte si koordinator. Është vlerësim i kësaj gjykate se fitim i humbur duhet të llogaritet paga që ai kishte me kontratë të punës, kurse shtesat që ai realizonte sipas qarkullimit të mallit, nuk mund të llogaritet, ngase nuk ka qenë e ardhur e sigurtë, por varej nga puna shtesë që paditësi realizonte, pra nga proaktiviteti i tij. Duke qenë se ai nuk ka punuar për katër muaj para se ti shkëputej kontrata e punësimit, ai ka të drejtë në pagat sipas kontratës së punës. Kjo gjykatë detyroi të paditurën që paditësit t'i paguaj pagat bruto sipas kontratës së punës, duke vlerësuar si kompensim të drejtë dhe shmangur kthimin e lëndës në rigjykim.

Po ashtu edhe për sa i përket kamatës ligjore, gjykatë gjeti se gjykata e shkallës së parë ka kalkuluar të njëjtën në kundërshtim me dispozitat e LMD-së, ngase ka caktuar rrjedhën e saj nga data 27.08.2016, madje pa u bërë të arritshme pagat, prandaj gjykata vendosi që rrjedha e kamatës të jetë nga data 31.12.2016 e deri në përmbushjen definitive, në lartësi prej 8%.

Sa i përket vendimit mbi shpenzimet procedurale, Gjykata e Apelit e ka vërtetuar vendosjen e shkallës së parë lidhur me to, meqenëse i njëjti vendim, është mbështetur në nenin 452.1 dhe 463 të LPK-së.

Nga arsyet e cekura Gjykata e Apelit vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 195 paragrafi 1 pika (d) dhe pika (e) e lidhur me nenin 200 të LPK-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI CIVIL
Ac.nr.10475/2021, më datë 07.05.2024

Kryetari i Kolegjit, Gjyqtari
Dardan Kadolli